

Anibar

Anibar është një organizatë e formuar nga një grup i të rinjëve, të cilë kanë dëshmuar entuziasmin dhe vizionin e tyre për të promovuar kulturën e filmit të animuar në nëntë edicionet e fundit të festivalit, gjithashtu duke demonstruar kapacitetet e zhvilluara për të organizuar ngjarje të mëdha. Anibar ka investuar në kapacitetin e zhvillimit të të rinjëve dhe fëmijëve nëpërmjet trajnimeve, punëtorive, debateve dhe aktiviteteve të tjera që ju mundëson të gjithë artistëve kosovarë dhe ballkanik të rritin dukshmërinë e tyre ndërkombëtarisht.

Anibar kërkon një kandidat/e për pozitën **Kordinator/e për Media dhe Marketing**

Përgjegjësitë e punës përfshijnë:

- Ekzekutimi i strategjisë vjetore të marketingut dhe promovimit të Anibar dhe përditësimi i saj në bashkëpunim me antarët tjerë të stafit;
- Menaxhimi i webfaqes dhe i llogarive të organizatës në media sociale dhe krijimi i materialeve/përmbajtjes për to;
- Mirëmbajtja e marrëdhënieve dhe krijimi i marrëdhënie të reja me mediat vendore e ndërkombëtare;
- Përgatitja e njoftimeve dhe materialeve të tjera informuese për shtyp;
- Përfaqësimi i Anibar-it në intervista dhe paraqitje mediatike;
- Përgatitja e raporteve dhe analizave relevante për shqyrtim nga stafi menaxhues;
- Përpilimi dhe shpërndarja e buletinit të organizatës;
- Asistimi i kordinatorëve të projekteve në hartimin e planeve të marketingut dhe të PR për projekt propozimet e organizatës;
- Koordinimi i ekipit të mediave për festivalin;
- Kërkimi dhe lidhja e marrëdhënieve me sponsorë;
- Detyra të tjera shtesë që lidhen me detyrat e përshkruara të punës.

Kandidatët është e domosdoshme të kenë:

- Përvojë relevante në fushën e marketingut dhe PR;
- Diplomë universitare në fusha relevante (gazetari, marketing, komunikim masiv);
- Njohuri të mira në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe angleze;
- Kreativitet në krijim të përmbajtjes për webfaqe dhe media sociale;
- Shkathtësi në përdorimin e programeve kompjuterike dhe mediave sociale;
- Fleksibilitet, përkushtim dhe gatishmëri për të punuar në një mjedis multi-kulturor.

Për të aplikuar dërgoni në info@anibar.com:

- Një rezume/CV që dëshmon kualifikimet e kërkuara;
- Letër motivimi ku argumentoni se pse duhet të pranoheni;
- Listë me referenca.

Afati i fundit për aplikim është 1 Nëntor 2018. Aplikantët e përzgjedhur do të trajnohen nga stafi aktual në pozitën e kërkuar dhe nga stafi shtesë.